VENDIM
Nr.534, datë 1.5.2008

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË KOMUNËS UDENISHT TË QARKUT TË KORÇËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Udenisht të qarkut të Korçës, sipas lidhjes 1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit, territorial dhe administrativ, të komunës Udenisht të qarkut të Korçës, miratuar me vendimin nr.15, datë 31.5.2007 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Udenisht të qarkut të Korçës".

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Udenisht për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Udenisht Lidhja nr. 1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	**Fusha e përdorimit të pronës**	**Lloji i transferimit**
7-13	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
1,	Prona që përdoren në fushën administrative	Në pronësi
5,21-25	Prona që përdoren në fushën e zhvillimit ekonomik	Në pronësi
26-28	Prona që përdoren në fushën e shëndetit publik	Në pronësi
14-20	Prona që përdoren në fushën kulturore sportive	Në pronësi
30-38	Shërbim funeral	Në pronësi
50-63,	Prona që përdorën në fushën e infrastrukturës. Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çfarëdo lloji	Në përdorim

232,233,238,239,244,245,248,249,252,253,254,259,260,	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim
234-237,240-243,246,247,250,251,255-258,261,266,270,278,285,289,	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka inproduktive dhe kanale të treta)	Në pronësi
64-92	Sistemi i furnizimit me ujë të pijshëm	Në pronësi